

U R D H Ë R

Nr 65 Datë 09.02.2006

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE TË SHFAQUR NË ARGJENTINË

Mbështetur në Ligjin “ Për Shërbimin dhe Inspektoriatin Veterinar” Nr. 9038 datë 4.11.2004.
Mbështetur në njoftimin e marrë nga Organizata Botërore e Shëndetit të Kafshëve(OIE) për shfaqjen e sëmundjes së Aftës Epizootike në Argjentinë. Mbështetur në Kodin Ndërkombëtar të Shëndetit të Kafshëve.

U R D H Ë R O J :

1. Ndalohet importimi i kafshëve të gjalla të llojeve: gjedhë, derra, bagëti të imta nga territori i Argjentinës për në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të ngarkesave të nisura për në Shqipëri para datës 05.02.2006, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.
2. Ndalohet importimi i mishit dhe qumështit të papërpunuar, që origjinojnë nga kafshët e përshkruara në pikën 1, nga territori i Argjentinës për në territorin e Republikës së Shqipërisë me përjashtim të ngarkesave të nisura për në Shqipëri para datës 05.02.2006, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.
3. Nënproduktet e mishit dhe qumështit të përpunuara lejohen të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë kur plotësojnë kushtet si më poshtë:
 - a- Të jenë me origjinë nga zona të pa prekura nga sëmundja e Aftës Epizootike,
 - b- Të jenë të përpunuara në fabrika të lejuara për eksport,
 - c- Të jenë të përpunuara në kushte teknologjike që shkatërrojnë virusin e Aftës Epizootike.
 1. Certifikata Veterinare e Argjentinës të garantojë origjinën e ketyre nënprodukteve dhe të konfirmojë kushtet e pikës 3 të këtij urdhëri.
 2. Ndalohet importimi i ushqimeve për blektorinë që kanë në përbërjen e tyre produkte me origjinë shtazore,
 3. Ndalohet importimi i materialeve biologjike nga territori i Argjentinës për në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 4. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohen Drejtoria e Përgjithëshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë , Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Inspektoriati Veterinar në Pikat e Inspektimit Veterinar Kufitar

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Jemin Gjana